

KRYEMINISTRI KOVAČEVSKI NË LSHPM

TAKIMI QË DO TË MBAHET MEND

Kryetarja Trajkova e njoju kryeministrin me të arriturat dhe rezultatet e Lidhjes, por edhe me problemet dhe çështjet e pazgjidhura që janë në interes të shfrytëzuesve të pensioneve dhe që si të tilla janë prioritet i Lidhjes

Më 7 mars të këtij viti, kryeministri, Dimitar Kovaçevski u takua me njerëzit e parë të LSHPM-së, kryetaren e Lidhjes, Stanka Trajkova, nënkyetarin e KE, Mentor Qoku dhe Sekretaren e KE, Menka Temelkovska. Në takim morën pjesë edhe pensionistët tjerë nga disa prej shoqatave. Në fillim të takimit, kryetarja Trajkova falënderoi kryeministrin Kovaçevski, i cili edhe përkundër obligimeve të shumta, gjeti kohë të takohet me pensionistët dhe në këtë mënyrë të tregojë respekt për qytetarët më të vjetër në vend. Më pas, kryetarja Trajkova e njoju kryeministrin me të arriturat dhe rezultatet e Lidhjes, por edhe me problemet dhe çështjet e pazgjidhura që janë në interes të shfrytëzuesve të pensioneve dhe që si të tilla janë prioritet i Lidhjes.

"Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë për gati një vit dha propozimet e saj për ndryshimin e formularës për harmonizimin e pensioneve dhe këtu pas dy takimeve të punës epilogu është pozitiv - pensionet si zgjidhje sistematike dhe ligjore do të harmonizohen dy herë në vit me 50% nga rritja e pagave të të gjithë punonjësve dhe me 50% nga rritja e kostos së jetesës. Është mirë që zgjidhja e re me-



todologjike do të përkthehet në ligj, e cila do të jetë një siguri e madhe juridike për pensionistët. Kjo do të thotë se pensionet nuk do të vendosen me akt të cilësdo qeveri, por me ligj që ofron një zgjidhje të shëndetshme dhe të paanshme", tha Trajkova.

"Bashkëpunimi me Lidhjen e shoqatave të pensionistëve dhe me të gjithë aktorët përkatës social për ne si Qeveri është i një rëndësie të madhe, sepse së bashku në konsultim me ju do të marrim vendime. Vendimet e tilla janë gjithmonë shumë më të mira sesa kur merren në mënyrë të njëanshme. Sa i përket pensioneve, ato do të harmonizohen në muajin mars dhe shtator sepse Enti Shtetëror i Statistikës atëherë publikon të dhënat zyrtare përritjen e pagës mesatare", tha Kovaçevski dhe shtoi se Qeveria menjëherë do të fillojë me aplikimin e metodës së re, ndërsa pensionistët do t'i marrin pensionet e tyre me shumën e rritjes nga shtatori i këtij viti.

"Edhe para këtij takimi, në dy takimet që patëm, përmes një dialogu të hapur me udhëheqësinë tuaj, siguruam

rritje të vazhdueshme të pensioneve, dhe rrjedhimisht të standardit tuaj të jetesës dhe cilësisë së jetës. E pranuam modelin e propozuar nga Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë si metodologji e re përritje të vazhdueshme të pensioneve, për të cilën e diskutuan me FMN-në dhe Bankën Botërore si financues ndërkombëtarë të vendit tonë dhe kemi mbështetjen e tyre. Atë që premtuan përmes dialogut do ta realizojmë sa më shpejt dhe do të fillojë të aplikohet me pensionin e shtatorit. Në takim nga kryetarja juaj Stanka Trajkova dëgjoja disa propozime dhe iniciativa konstruktive që janë me interes për pensionistët dhe ato do të shqyrtohen me ministritë përkatëse sipas përbajtjes. Tremijë denarët ndihmë e drejtëpërdrejtë financiare për thuajse 330 mijë pensionistë me nga 1.000 denarë do të paguhen me pensionet e marsit, prillit dhe majit nga Fondi pensional. Shpresoj se deri në fund të vitit pensioni mesatar do të jetë rreth 17.300 denarë", u shpreh në fund Kovaçevski. Ky ishte me të vërtetë një takim për t'u mbajtur mend. (KSA)



Hapet klub i ri i pensionisteve në Fushë Topanë

Një nga përbajtjet më të rëndësishme programore të Kryesisë së Shoqatës së pensionistëve Çair, dhe për të krijuar kushte dhe për të mundësuar një jetë sa më komode dhe kuptimplotë për pensionistët, është sigurisht hapja e klubeve të pensionistëve. Pensionistët nga SHP Çair deri më tanë kishin në dispozicion vetëm klubin në shtëpinë e të moshuarve "Lika Çopova", ndërsa nga 14 marsi i këtij viti iu bashkua edhe klub i vendosur në kompleksin tregtar në lagjen e Fushë Topanës, hapësira në pronësi të komunës, e cila e ka rregulluar në tërsë. Në hapjen e klubit krahas një numri të madh të pensionistëve morën pjesë edhe kryetarja e LSHPM-së, Stanka Trajkova, e cila i dhuroi klubit katër komplete domino, nënkyetari i KE të LSHPM-së, Mentor Qoku dhe Sekretari i Përgjithshëm i Komunës së Çairit, Faruk Nevzati. Në fillim të ceremonisë, të pranishmëve në emër të shoqatës iu drejtua kryetari i KE Todor Iliev, i cili i përshëndeti të pranishmit, duke shprehur njëherazi mirënjojje për komunën, në veçanti për kryetarin Visar Ganiu, i cili e dha dhe e pajisi hapësirën e klubit të ri të pensionistëve. Ai theksoi se me hapjen e klubit, pensionistët nga Lagjja e Fushë Topanës kanë fituar një kat të ri të tyre përmirësuar. Duke iu drejtuar të pranishmëve, kryetarja e LSHPM-së, Stanka Trajkova tha se kjo ditë është shumë e rëndësishme për pensionistët nga SHP Çair, sepse komuna tregon një qëndrim serioz dhe të përgjegjshëm ndaj popullatës së moshuar. Duke shtuar se Shoqata e pensionistëve nga Çairi është një shoqatë që vizitet e fundit po rritet me të vërtetë dhe po shquhet duke praktikuar gjithçka që është në interes të pensionistëve. Ajo shprehur mirënjojje të madhe për Komunën e Çairit dhe veçanërisht kryetarin Visar Ganiu përmirësuar. Duke shtuar se "Ne si vetëqeverisje lokale gjithmonë do t'ju mbështesim dhe do t'ju ndihmojmë në realizimin e projekteve tuaja, sepse ju e meritoni", duke e shpallur klubin të hapur, tha sekretari Nevzati. (V.P.)

PROBISHTIP

Në "Lakrori i Gjyshes" u shoqëruan mbi 4000 vizitorë

Pas një pauze dy vjeçare, për shkak të pandemisë Covid 19 në prag të pranverës, u zhvillua edicioni i 9-të i një prej etno eveneteve më atraktive "Lakrori i Gjyshes", një ngjarje që tejkaloj të gjitha priftshëmërët e mikpritësve dhe të ftuarve. Organizuar nga Komuna e Probishtipit, më 19 mars në shezin e qytetit "Shën Gavril Lesnoverski" u mbajt manifestimi "Lakrori i Gjyshes", i cili qysh në fillim tregoi interesim të madh nga pothuajse të gjitha qytetet e vendit që së bashku me nikoqirët numëronin mbi 4000 adhurues të specialitetave tradicionale maqedonase të brumërave, por dominonte lakroi i bëre sipas recetës së gjysheve tona, dhe shumica prej tyre ishin pensionistë.

Sivjet, përkundër lehtësimit të masave për shkak të pandemisë, nikoqirët vendosën të kufizojnë numrin e pjesëmarrësve, kështu që morën pjesë 18 shoqata të pen-



sionistëve nga Maqedonia, por nuk pati pjesëmarrje të mysafirëve tanë tradicionalë nga Serbia dhe Bullgaria, të cilët me pjesëmarrjen e tyre i dhanë karakter ndërkombëtar këtij evenimenti. Veç prezantimit të lakrorëve dhe shumë brumërave të tjera, manifestimi pati edhe përbajtje të tjera, secila më interesante se tjetra. Në vend të ngjarjes zihet brumi, rrotulloheshin koret, vendoseshin në tepsi, vendosej zarzavatja dhe piqej nën saç, siç bënin gjyshet tona. Shkathtësia e përdredhjes së shpejtë kishte karakter konkurrues. Në tavolinat e ngritura rreth shatërvanit në sheshin e qytetit garuan nëntë pjesëmarrës nga 9 qytete, mes tyre edhe një djali i ri, i cili dëshmoi se edhe burrat janë mjaft të aftë në këtë punë. Koha e të gjithëve matej, kurse epitetin e më të shpejtës e mori Zhivka Blazevska nga SHP Gazi Babë - Shkup, e cila për vetëm 10 minuta përdrohhi 8 kore dhe bëri një lakror të shijshëm.

Krahas zënies së shpejtë, interesante ishte edhe punëtoria edukative, ku tri gra u tregonin disa vajzave se si gatuhet brumi, sa është raporti i miellit me ujin dhe çfarë tjetër futet në brumë për t'u treguar më në fund se si rrotullohet korja. Juria kishte një detyrë shumë të vështirë dhe të përgjegjshme, sepse duhej të përcaktonte tryezën më të shpejt dhe më të pasur. Të ftuarit nga SHP Prilep morën epititin për tryezën më të shpejt të rregulluar dhe zbukuruar.

Manifestimi "Lakrori i Gjyshes" kishte edhe karakter humanitar. Të gjitha produktet e brumit shiteshin në copa dhe fondet e mbledhura shkojnë për bamirësi. Pas marrjes së vendimit se cilat ishin më të mirat, edhe kryetari i Komunës së Probishtipit, Dragan Anastasov bëri një xhiro, i cili u befasua shumë nga tryezat e pasura dhe të shijshme të përgatitura nga të gjitha qytetet pjesëmarrëse në

manifestim dhe të njëjtën e vlerësoi si të shkëlqyeshme dhe reprezentative për pjesëmarrësit dhe qytetin.

Krahas lakrorit dhe specialitetave të tjera nga brumi, u përgatit një program i pasur kulturo-artistik për të pranishmit dhe mysafirët me emra të njohur të muzikës populllore maqedonase, etno grupe nga qyteti nikoqirë dhe valltarët e AF "Kitka" nga Istibanja, të cilët prezantuan folklorin i pasur të vendit tonë. Si pjesëmarrësit ashtu edhe të ftuarit kaluan një ditë të mrekullueshme dhe të paharrueshme, të mbushur me shumë përbajtje dhe oferta të produkteve të ndryshme që mund të blihen si kujtim i këtij manifestimi. 19 Marsi dhe "Lakrori i Gjyshes" do të mbeten gjatë në kujtesën e të gjithë të pranishmëve, për shkak të cilësisë, shumëlojshmërisë së përbajtjes dhe masës së madhe. Milevka Zdravkovska